



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 5 të Rregullës Zgjedhore Nr. 06/2013 Qendra e Numërimit dhe Rezultateve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 02.03.2021, nxjerr këtë:

## VENDIM

### Për Miratimin e Rekomandimit të Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve për Mos Përfshirje në Rezultate Përfundimtare Vendvotimi Nr. 2717B/01R dhe Vendvotimi Nr.3805B/05R për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021

- I. Miratohet rekomandimi i Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për mos përfshirjen në rezultate përfundimtare, vendvotimi Nr. 2717B/01R dhe vendvotimi Nr.3805B/05R, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të datës 14.02.2021.
- II. Obligohet Sekretariati për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti detaj dhe i specifikuar sipas vendvotimeve nga QNR-ja.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Duke u bazuar në rekomandimin e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (QNR) të datës 02.03.2021, QNR, gjatë hetimit të vendvotimet në fjalë dhe pas verifikimit të të gjitha fletëvotimeve, diferenca në mes të nënshkrimeve dhe fletëvotimeve e tejkalon nivelin e tolerancës +/- tre (3).

Në vendvotimin Nr.2717B/01R janë pesë (5) fletëvotime më shumë se nënshkrime, ndërsa në vendvotimin Nr.3805B/05R janë dhjetë (10) fletëvotime më shumë se nënshkrime.

Prandaj, i është rekomanduar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që vendvotimet e lartcekura të mos përfshihen në rezultatet përfundimtare, sepse edhe pas procesit të rinumërimit ka rezultuar se kanë pasur mospërputhje në mes të nënshkrimeve dhe fletëvotimeve. Andaj, KQZ-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 02.03.2021

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

  
Valdete Daka  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Republika e Kosovës  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Për: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Nga: Burim AHMETAJ, Kryeshef Ekzekutiv i SKQZ-së

Datë: 02-03-2021

Lënda: Raport i verifikimit të dy vendvotimeve të rinumëruara në QNR

---

Qendra e Numërimit dhe Rezultateve pas procesit të rinumërimit të vendvotimeve krijon Formularët e rinj me rezultatet që dalin pas procesit të rinumërimit.

Të gjithë Formularët e Rezultateve i nenshtrohen procesimit sipas procedurave në bazën e të dhënave dhe nga të gjithë Formularët e rinumëruar vetëm 2 Formular të Rezultateve nga vendvotimet 2717B/01R dhe 3805B/05R nuk kanë mundur të procesohen si të rregullta dhe nuk e kanë kaluar Auditimin, pra nuk mund të procesohen si

**Të gjeturat:** QNR ka hetuar vendvotimet në fjalë dhe edhe pas verifikimit të të gjitha fletëvotimeve, diferenca në mes të nënshkrimeve dhe fletëvotimeve e tejkalon nivelin e tolerancës +/-3. Në vendvotimin 2717B/01R janë 5 fletëvotime më shumë se nënshkrime dhe në vendvotimin 3805B/05R janë 10 fletëvotime më shumë se nënshkrime.

#### **Rekomandimi 1**

Rekomandohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që vendvotimi 2717B/01R i cili edhe rinumërimit rezulton se ka mospërputhje në mes të nënshkrimeve dhe fletëvotimeve, janë 5 fletëvotime më shumë se nënshkrime, të mos përfshihet në Rezultatet përfundimtare.

#### **Rekomandimi 2**

Rekomandohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që vendvotimi 3805B/05R i cili edhe rinumërimit rezulton se ka mospërputhje në mes të nënshkrimeve dhe fletëvotimeve, janë 10 fletëvotime më shumë se nënshkrime, të mos përfshihet në Rezultatet përfundimtare.